



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 749/Prot.  
125

Tiranë, më 11.2. 2021

**Lënda:** Mbi zhvillimin e disa prej provimeve të lëndëve specifike në auditor.

**UNIVERSITETIT TË TIRANËS**

*Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.3, Tiranë*

**UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS**

*Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Nr. 4, Tiranë*

**UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË**

*Adresa: Rruga e "Dibrës", Nr. 371, 1005, Tiranë*

**UNIVERSITETIT BUJQËSOR TË TIRANËS**

*Adresa: Rruga "Pajsi Vodica", Kodër Kamëz, Tiranë*

**UNIVERSITETIT TË ARTEVE, TIRANË**

*Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr. 2, Tiranë*

**UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS**

*Adresa: Rruga "Muhamet Gjollesha", Tiranë*

**UNIVERSITETIT TË SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"**

*Adresa: Sheshi "2 Prilli", nr. 24, Shkodër*

**UNIVERSITETIT TË ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"**

*Adresa: Rruga "Ismail Zyra", Elbasan*

**UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORË**

*Adresa: Skelë, Rruga "Kosova", 9401, Vlorë*

**UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI", KORÇË**

*Adresa: Bulevardi "Rilindasit I", Korçë*

**UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ", GJIROKASTËR**

*Adresa: Rruga "Studenti 30", Gjirokastër*

**UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU", DURRËS**

*Adresa: Rruga "Currila", 14, 2001, Durrës*

**AKADEMISË SË FORCAVE TË ARMATOSURA**

*Adresa: Rruga "Odhise Paskali", Tiranë*

**AKADEMISË SË SIGURISË**

*Adresa: Rruga e "Elbasanit", Tiranë*

**UNIVERSITETIT "ALBANIAN UNIVERSITY"**

*Adresa: Bulevardi "Zogu I", 1001, Tiranë*

**UNIVERSITETIT "BARLETI"**

*Adresa: Rruga "Sami Frashëri", nr. 41, Tiranë*

**UNIVERSITETIT EUROPIAN TË TIRANËS**

*Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta" Nd. 70, H.1, Njësia Bashkiake Nr.7, Tiranë*

**UNIVERSITETIT "ALDENT"**

*Adresa: Rruga e "Dibrës", Tiranë*

**KOLEGJIT UNIVERSITAR "TBU"**

*Adresa: Rruga "Vaçe Zela", Tiranë*

**KOLEGJIT UNIVERSITAR "BEDËR"**

*Adresa: Kompleksi "Usluga", Rruga "Jordan Misja", Tiranë*

**KOLEGJIT UNIVERSITAR "REALD"**

*Adresa: Rruga "Zahir Pajaziti", Vlorë*

**KOLEGJIT UNIVERSITAR TË BIZNESIT**

*Adresa: Rruga "Vangjel Noti", Nr. 25, Laprakë, Tiranë*

**KOLEGJIT UNIVERSITAR "INSTITUTI KANADEZ I TEKNOLOGJISË"**

*Adresa: Rruga "Xhanfize Keko", Kompleksi "Xhura", nr.12, Tiranë*

**KOLEGJIT UNIVERSITAR "QIRIAZI"**

*Adresa: Rruga "Taulantët", Kodër-Kamëz, Tiranë*

***Të nderuar Rektorë,***

Bazuar në kërkesat tuaja zyrtare të paraqitura pranë MASR, nëpërmjet të cilave keni kërkuar zhvillimin në auditor të disa provimeve për lëndë specifike, në datë 05.02.2021, i drejtova Komitetet Teknik të Ekspertëve me shkresën nr.749/18, datë 05.02.2021, propozimin për mënyrën e zhvillimit të disa prej provimeve në sezonin e semestrit të parë të vitit akademik 2020-2021.

Në mbledhjen e ditës së djeshme datë 10.02.2021, Komiteti Teknik i Ekspertëve, deklaroi zgjatjen e sezonit të provimeve në IAL, për të siguruar kombinimin e provimeve "online" dhe në auditor, për lëndët që kërkojnë prezencë, duke respektuar rreptësisht protokollet anti-COVID.

Bazuar në këtë deklaratë të Komitetit Teknik të Ekspertëve, duke qenë se përgjegjësia jonë e përbashkët është shumë e lartë, për të garantuar një proces të rregullt të përmbylljes së semestrit të parë të vitit akademik 2020-2021, ku natyrisht prioriteti absolut është shëndeti dhe jeta e gjithsecilit, kërkojë bashkëpunimin tuaj për të konsideruar masat e mëposhtme:

1. Në ato raste, kur provimi i lëndës është e pamundur të zhvillohet "online", për arsye të specifikave të lëndës, sipas kërkesave që keni paraqitur zyrtarisht në MASR, provimi mund të zhvillohet në auditor, duke respektuar me korrektësi maksimale

- protokollet anti-COVID, në fuqi;
2. Të vlerësohet nga ana juaj, dhënia e të drejtës studentëve të vendosin nëse do të marrin pjesë apo jo në këtë sezon të provimeve, në varësi të mundësisë apo pamundësisë së tyre për arsye që lidhen si me teknologjinë ashtu dhe me pandeminë. Të gjithë studentëve që nuk do të marrin pjesë në këtë sezon, t'u sigurohet mundësia e një sezoni shtesë të ndërmjetëm, në varësi të përmirësimit të situatës së pandemisë;
  3. Kohëzgjatja e sezonit të jetë më shumë se 45 ditë, për të krijuar diferencë kohore ndërmjet provimeve, me qëllim parandalimin e grumbullimeve në mjediset e IAL-ve, si dhe ardhjen në ndihmë të studentëve për të pasur më shumë kohë për t'u përgatitur në provime;
  4. Mungesat e studentëve në leksionet apo seminarët "online" të mos i penalizojnë studentët për pjesëmarrje në provime, duke vlerësuar vështirësitë objektive që mund të kenë pasur një pjesë e studentëve gjatë kësaj periudhe;
  5. Konsiderohet shumë e rëndësishme dhe për këtë arsye sjell edhe një herë në vëmendjen tuaj garantimin e kushteve, për të minimizuar riskun e infektimit për studentët dhe gjithë personelin akademik. Për këtë arsye duhet që:
    - ✓ Ndarja e studentëve të bëhet në grupe dhe orare të ndryshme;
    - ✓ Numri i studentëve në sallë të jetë jo më shumë se 15 studentë, duke garantuar distancën e nevojshme, sipas protokolleve në fuqi;
    - ✓ Kohëzgjatja e provimeve të jetë jo më shumë se një orë,
    - ✓ Mbajtja e maskës të jetë e detyrueshme, gjatë gjithë kohëzgjatjes së qëndrimit në mjediset e IAL-ve;
    - ✓ Higjienizimi i mjediseve në mënyrë të vazhdueshme dhe i sallave të kryhet para dhe pas çdo provimi.
  6. Çdo IAL, sa më shpejt të jetë e mundur, duhet të përgatisë një rregullore të detajuar për sezonin e provimeve të semestrit të parë të vitit akademik 2020-2021, në mënyrë që të garantohet mbarëvajtja dhe përfundimi me sukses i këtij procesi.

Gjithashtu, duke ju falënderuar për durimin, sakrificën dhe bashkëpunimin e treguar deri më tani, shpresoj në mirëkuptimin tuaj për të vijuar këtë bashkëpunim deri në përmirësimin e situatës së krijuar nga pandemia COVID-19.

*Së fundmi, gjej rastin t'ju uroj një sezon të mbarë provimesh!*

MINISTRI

Evis KUSHI

